

Karta e apostollit Pavël mbë Gallatianëtë.

Krye. 1.

- 1 Pavli, apostoll (jo prej njerëzish, as me
anë njeriu, po me anë të Jisu Krishtit, edhe
të Perëndisë Atit që e ngjalli atë prej së-
2 vdekurish,) Edhe gjithë vëllezëritë që janë
bashkë me mua, mbë kishërat të Gallatisë;
3 Hir *qoftë* mbë ju edhe paqtim nga Perëndia
4 Ati, edhe nga Zoti ynë Jisu Krisht, Që dha
vetëhen' e ti për fajetë t'anë, që të na shpë-
tonjë nga këjo jet' e-ligë, pas dashurimit të
5 Perëndisë edhe Atit t'ënë, Mbe të-cilinë *qoftë*
lavdia ndë jetët të jetëvet. Amin.
- 6 Çuditëm se kaqë çpejt shkoni prej ati që
u thirri juve me anë të hirit të Krishtit ndë
7 tjetërë ungjill; I-cili nuk' është tjetërë, po
janë ca *veta*, të-cilëtë u trumbullonjënë juve,
edhe duanë të ndryshonjënë ungjillin' e Krish-
8 tit. Po edhe neve, a ëngjëll prej qielli ndë u
lëçittë juve *tjetër'* ungjill e jo atë që u lëçit-
9 më juve, *qoft'* i mallëkuarë. Sikundrë thamë
më përpara, edhe ndashti përsëri them, Ndë
u lëçittë juve ndonjë *njeri tjetër'* ungjill e jo
10 atë që kini marrë, *qoft'* i-mallëkuarë. Sepse
ndashti njerësvet u mbush mëndjenë unë apo

Perëndisë? apo kërkonj të pëlqehem te njerëzit? sepse ndë pëlqeheshe edhe të njerëzitë, nukë dotë ishnjam shërbëtuar i Krishtit.

- 11 Po u bënj të dini ju, o vëllezër, se ungjilli që ulëçit prej meje s' është pas njeriu;
- 12 Sepse as unë s' e mora prej njeriu, as unësushë prej njeriu, po prej sbulese së Jisu Krishtit. Sepse kini dëgjuarë, se qysh shkonnjam njëherë ndë Judhaismët, se fort tepërë ndiqnjam kishën' e Perëndisë, edhe e bënjam 14 rrëmullë; Edhe vinjam mbarë ndë Judhaismët më tepërë se shumë moshëtarë të mi ndë kompt t'im, sepse ishnjam më tepërë zilitar për porositë që kishinë lënë atërit' e mi.
- 15 Po kur i pëlqeu Perëndisë që më ndau veç që nga barku i mëmësë, edhe më thirri 16 me anë të hirit të ti, Që të sbulonjë Birin' e ti tek unë, që t'a ungjillëzonj atë ndër kombet, për-një-here s'mora këshillë nga mish 17 a nga gjak; As nukë hipa ndë Jerusolim te apostojtë që qenë përpara meje, po vajta nd' Aravi, edhe përsëri ukthyeshtë ndë Dhamaskë.
- 18 Pastaj pas tre vjeç hipa ndë Jerusolim, për të pjekurë me Pjetrinë; edhe mbeta për'an' 19 ati pesë-mbë-dhjetë dit; Edhe tjetërë nga apostojtë nukë pashë, veç Jakovinë të vëllan' 20 e Zotit. Edhe sa u shkruanj juve, ja tek po 21 rrëfenj përpara Perëndisë, se s'gënjenj. Pastaj erdha ndë vëndet të Syrisë edhe të Qilijë; Edhe nukë ishnjam njohurë me faqe me

- 23 kishët' e Judhesë që ishinë mbë Krishtinë; Po vetëmë kishinë dëgjuarë, se ay që na ndiqte njëherë, ndashti po ungjillëzon atë besënë që 24 bënte rrëmullë njëherë. Edhe lavduroninë Perëndinë për punë t'ime.

Krye 2.

- 1 Pastaj pas katër-mbë-dhjetë vjeç përsëri hipa ndë Jerusolim bashkë me Varnanë, si 2 mora me vetëhe edhe Titonë; Edhe hipa pas sbulese nga an' e Perëndisë, edhe u rrëfeva atyre ungjillinë që lëçis ndër kombet, po më tepërë atyreve që dukeshinë më të-shënuarë, 3 nga frika semos breth, a brodha mbë kot. Po as Titua që qe bashkë me mua, ndonëse ishte Grek, nuk' ushtrëngua të rrethprietë;
- 4 Edhe këjo për vëllezërit' e-rrem që ishinë futurë fshehuraj, të-cilëtë hynë fshehuraj, për të përgjuarë lirinë t'ënë që kemi mbë Jisu 5 Krishtinë, që të na bënë robër; Këtyreve as për një orë nuk' u uunjmë kryetë që t'u bindemi, që të mbësë te ju e-vërtet' e ungjillit. Edhe për ata që u duketë se diç janë, 6 çfarëdo që të kenë qënë ndonjëherë, asfare s'dua të di; Perëndia nukë shikon mbë faqe njeriu; sepse ata që dukenë se diç janë nukë 7 shtuanë gjë tek unë; Po përkundrazi, kur panë se mua m'ubesua ungjilli i parrethpresjesë, sikundrë Pjetrit ungjilli i rrethpresjesë; 8 (Sepse ay që vepëroj mbë Pjetrinë që të jetë

apostoll mbë të-rrethprerëtë, vepëroj edhe mbë mua *që të jem apostoll* mbë kombetë;)

9 Edhe si e njohinë hirinë që m'udha, Jakovi e Qifaj e Joani, të-cilëtë dukeshinë së ishinë shtylla, *na dhanë* mua edhe Varnavësë të-djathtat' e tyre për *shënjë* shoqërie, që neve *të vemi* ndër kombet, e ata ndër të-rrethpre-

10 rët; Vetëmë *na porosinë* të kujtojmë të-vo-
beqtë; të-cilënë punë edhe ukujdesa t'a bënj.

11 Edhe kur erdhi Pjetri ndër Antiohi, i ndën-
ta kundrë për faqe, sepse vëjente te qërto-
12 nej; Sepse pa ardhurë ca *veta* nga Jakovi,
hante bashkë me kombetë; po kur erthnë, hiqej
edhe e ndante *veç* vetëhen' e ti, sepse kishte

13 frikë nga ata që ishinë prej rrethpresjesë. Edhe
bashkë më atë uhoqnë *veç* edhe të-tjerëtë Ju-
dhenj, kaqë sa edhe Varnava uhoq ndër ipo-

14 krisit t'atyreve. Po kur pashë, se nuk'ecënjënë
drejt sipas së-vërtetës' s' ungjillit, i thashë
Pjetrit përpara të gjithëve, Ndë qoftë se ti
që je Judhe rron posi kombetë, e jo posi
Judhenjtë, përse shtrëngon kombetë të rro-

15 njënë posi Judhenjtë? Neve që jemi prej fisi
16 Judhenj edhe jo prej kombesh fajtoje, Dyke
diturë, se s'del i-drejtë njeriu prej punërash
nomi, *veç* me anë të besës' së Jisu Krishtit,
edhe neve i besuamë Jisu Krishtit, që të da-
lëmë të-drejtë prej besës' së Krishtit, e jo
prej punëravet të nomit; sepse asndonjë njeri
s'ka për të dalë i-drejtë prej punëravet të

17 nomit. Po ndë qoftë se, dyke kërkuarë të da-
lëmë të-drejtë mbë Krishtinë, ugjëntmë edhe
neve fajtorë, Krishti pa fjalë qënka shërbëtuar
i fajit? Qoftë lark.

18 Sepse ndë ndërtonj përsëri ato që prisha,
19 bënj vetëtëhenë t'ime porosi-prishës. Sepse
unë me anë të nomit vdiqa ndër nomt, që të
20 rronj mbë Perëndinë. Bashkë me Krishtinë u-
kryqëzuashë; Edhe s'rronj më unë, po Kri-
shti rron tek unë; edhe ajo që rron *unë* nda-
shti ndër misht, rronj ndër besët të Birit të
Perëndisë, i-cili më deshi edhe dha ndër duar
21 vetëhen' e ti për mua. Nukë heth poshtë hi-
rin' e Perëndisë; sepse ndë qoftë të-drejtua-
rëtë me anë të nomit, atëhere Krishti vdiq
mbë kot.

Krye 3.

1 O Gallatiannë të-marrë, kush u mëreu juve,
(që të mos bindeni mbë të-vërtetënë,) për-
para syvet të të-cilëvet Jisu Kristi upërshkrua
2 i-kryqëzuarë ndër mest t'uaj. Këtë vetëmë dua
të marr vesh prej jush, Prej punërash nomi e
muartë Frymënë, apo prej të-dëgjuarit të be-
3 sësë? Kaqë të-marrë qënki? passi nistë me
4 Frymë, ndashti mbaroni me mish. Mbë kot
pësuatë kaqë? ndë qoftë se vetëmë mbë kot.
5 Ay pra që u ep juve Frymënë, edhe punon çu-
dira ndër ju, prej punërash nomi *i bën këto*,
a prej të-dëgjuarit të besësë?

- 6 Sikundrë „Avraami i besoj Perëndisë, edhe
7 i unumërua ati për drejtëri;“ Di-e-ni pra, se
8 ata që janë prej besësë, këta janë bij t’A-
9 vraamit. Edhe shkronja dyke parë që përpara
10 se Perëndia nxjer kombetë të-drejtë prej be-
11 sësë, i dha zë Avraamit që përpara, „Se
12 gjithë kombetë dotë bekonenë mbë ty.“ Pë-
13 randaj ata që janë prej besësë bekonenë
14 bashkë me besëtarinë Avraam.
- 10 Sepse sa *njerës* janë prej punërash nomi
11 janë ndënë mallëkim; sepse është shkuarë,
12 „I-mallëkuarë është cilido që s’qëndron mbë
13 gjithato që janë shkruarë ndë vivlit të no-
14 mit, për të bër’ ato.“ Po se asndonjë s’del
15 i drejtë me anë të nomit përpara Perëndisë,
16 është *gjë* e-çfaqurë „Sepse i-drejti dotë rro-
17 një prej besësë.“ Edhe nomi nuk’ është prej
18 besësë, po „njeriu që bën ato, dotë ronjë me
19 anë t’atyrëve.“ Krishti na çpërbleu nga ma-
20 llëkimi i nomit, sepse ubë mallëkim për ne;
21 sepse është shkruarë „I-mallëkuarë është si-
22 cilido që varretë ndë dru.“ Që të vinjë bekimi
23 i Avraamit ndër kombet me anë të Iisu Kri-
24 shtit, që të marrëmë të-zotuarët’e Frymësë me
25 anë të besësë.
- 15 O vëllezër, si njeri flas; po *edhe* dhjatë
16 njeriu, passi vërtetonetë, asnjeri s’e heth
17 poshtë, a shton *gjë mb’ atë*. Edhe të-zotuarat’
18 i ufolnë Avraamit edhe farës’ s’ati; nukë
19 thotë, Edhe faravet, si per shumë, po si për

- 17 një „Edhe farësë s’ate,“ që është Kishti. Edhe
18 këtë e them, se dhjatënë që qe vërtetuarë
19 më përpara prej Perëndisë mbë Krishtinë
20 nomi që ubë pas katrë qint e tri-dhjetë vjeç
21 nuk’ e heth poshtë, që të prishnjë të-zotu-
22 arëtë. Sepse ndë qoftë se trashëgimi është
23 prej nomi, nuk’ është më prej të-zotuari; po
24 Perëndia j’a fali këtë Avraamit me anë të
25 të-zotuarit.
- 19 Përse pra *udha* nomi? Ushtua për punë
20 të të-shkeluravet të porosivet, gjersa të-vinte
21 fara, mbë të-cilënë qe bërë të-zotuarëtë; e-
22 dhe *ky nom* uurdhërua me anë ëngjëjve ndë
23 dorët të *një* mestari. Edhe mestari s’është i
24 njëj *vetëmë*; po Perëndia është një.
- 21 Nomi pra *qënka* kundrë të-zotuaravet të
22 Perëndisë? Qoftë lark! sepse ndë ishte dhënë
23 nom që munt të apë jetë, *atëhere* drejtëria dot’
24 ishte me të-vërtetë prej nomit; Po shkronja i
25 mbylli të-gjiitha ndënë fajinë, që t’u epetë të-
26 zotuarëte prej besësë mbë Jisu Krishtinë aty-
27 reve që besonjënë. Edhe përpara se të vinte
28 besa, ruheshimë ndënë nom, të-mbyllurë brën-
29 da ndë besët, e-cila ishte për të sbuluarë. Pë-
30 randaj nomi ubë mësonjësi ynë mbë Kristinë,
31 që të dalëmë të-drejtë prej besësë; Po passi
32 erdhi besa, s’jemi më ndënë mësonjës.
- 26 Sepse të-gjithë jemi të Perëndisë me anë
27 të besësë që është mbë Jisu Krishtinë. Sepse
28 sa jeni pagëzuarë mbë Krishtinë, Krishtinë

28 kini veshurë. Nukë ka *më* Judhe as Grek; nukë ka *më* shërbëtuar as të-lirë; nukë ka *më* mashkull e femërë; sepse ju të-gjithë jeni
29 mbë Jisu Krishtinë. Edhe ndë jini ju të Krishitit, pa fjalë, jini far' e Avraamit, edhe pas të-zotuarit trashëgimtarë.

Krye 4.

1 Edhe them, se sa kohë trashëgimtari ësh-të foshnjë, s'ndan nga shërbëtori, ndonëse
2 është' i zot' i të-gjithave; Po është ndënë qiver-nitarë e kujdestarë, gjer mb' atë kohë që është'
3 urdhëruarë nga i ati. Kështu edhe neve, kur ishimë foshnje, ishimë robër ndënë stihiat të
4 botësë; Po kur erdhi të-mbushurit' e kohësë, Perëndia dërgoj të Birinë, që lindi prej gru-
5 aje edhe që qe ndënë nom, Që të çpëblenjë ata që ishinë ndënë nom, që të marrënë bi-
6 rërinë. Edhe me-qënë-që jemi bij, Perëndia dërgoj Frymën'e Birit të ti ndë zëmërat t'uaj
7 që thërret, Avva, o Atë. Përandaj- nukë je me shërbëtuar, po bir; edhe ndë je bir, *je* edhe
trashëgimtar i Perëndisë me anë të Krishtit.
8 Po atëhere, passi s'njihnitë Perëndinë u punuatë atyreve që s'janë prej nature perën-
9 dira; Po ndashti, passi njohtë Perëndinë, e *që të them* më mirë unjohtë prej Perëndisë, qysh kthehi përsëri mbë të-dobëtat' e mbë
të-vobegatë stihia, të-cilavet prapë si për-
10 para doni t'u punoni? Vini re dit, e muaj,

11 e kohëra, e vjet. Kam frikë për ju semos mbë kot umunduashë për ju.
12 O vëllezër, u lutem juve bëhi posi unë, sepse edhe unë jam posi ju; s'më keni bërë
13 ndonjë të-keqe. Edhe e dini, se të-parënë herë u'a lëçita juve ungjillinë me dobësirë të
14 mishit. Edhe ngasjenë t'ime që kishnjam ndë mishit t'im nuk'e zutë për gjë, as e hothtë
tejt, po më prittë si ëngjëll Perëndie, si Jisu
15 Kristinë. Cila pra ishte lumeria juaj? Sepse dëshmonj për ju, se ndë mundej, *edhe* sytë
t'uaj dot' i nxirnitë e dotë m'i epnitë mua.
16 Armiku juaj pra ubëshë, se u them juve të-vërtetënë?
17 Dëftenjënë zëmërë të-përvëluarë te ju, po jo të-mirë; përkundrazi duanë t'u mbyll-
njënë. juve jashtë, që të keni *juve* zëmërë të-
18 përvëluarë për ata. Po *është* mirë të këni zëmërë të-përvëluarë për të-mirënë gjithënjë, e
19 jo vetëmë kur gjëndem ndë mest t'uaj. Djem-thit' e mi, përsëri kam të-dhëmbura të-pjelli
për ju, gjersa të formonetë Krishti ndër ju;
20 Edhe donjam të ishnjam ndë mest t'uaj ndashti, edhe të ndërrojam zënë t'im, sepse
nukë di ç'të mendonem për ju.
21 Pa më thoni, ju që doni të jeni ndënë
22 nom, a nukë dëgjoni nomnë? Sepse është shkruarë, se Avraami pat dy bij; një prej
23 shërbëtoresë, edhe një prej së-lirësë; Po ay që lindi prej shërbëtoresë lindi pas mishit; e

- ay që lindi prej së-lirësë, lindi me anë të të-
 24 zotuarit. Të-cilatë dëftenjënë tjetërë për tje-
 tërë; sepse këtu janë të dy dhjatatë; njëra
 nga mali Sina, që pjell për skllavëri, e-cila
 25 është Agara. (Sepse Agara është mali Sina
 nd' Arabi, edhe përgjigjetë ndë Jerusolimët të-
 sotme; edhe është ndë skllavëri bashkë me
 26 të bijtë.) Po Jerusalima që është lart është e
 27 lirë, e-cila është mëma e neve të gjithëve. Se-
 pse është shkruarë, „Gëzohu ti, o shterpë që
 nukë pjell; nxir zënë edhe thërrit ti që nukë ke
 të-dhëmdhura të-pjelli; sepse djemt' e shkretë-
 tëtirësë janë më shumë se t'asaj që ka bu-
 28 rrinë;“ Edhe neve, o vëllezër, jemi, posi Isa-
 29 aku, bij të të-zotuari. Po sikundrë atëhere ay
 që lindi pas mishit ndiqtë atë që kishte lin-
 durë pas frymësë, kështu është edhe ndashti.
 30 Po ç' thotë shkronja? „Nxir jashtë shërbëto-
 ren' edhe të birin' e asaj; sepse s'ka për të
 trashëguarë i bir' i shërbëtoresë bashkë me
 të birin' e së-lirësë.“
 31 Nukë jemi pra, o vëllezër, bij të shërbë-
 toresë, po të së-lirësë.

Krye 5.

- 1 Qëndroni pra ndë lirit, me të-cilënë na liroj Krishti, edhe mos hyni përsëri ndë sgejdhët të skllavërisë.
- 2 Ja unë Pavli te po u them juve, se, ndë urrethpeshi, Krishti nukë dot' u bënë juve

- 3 dobi asfare. Edhe dëshmonj përsëri mbë çdo njeri që rrethprietë, se është detuar të mba-
 4 një gjithë nominë. Undatë nga Krishti ju që delni të-drejtë me anë të nomit; ratë poshtë
 5 nga hiri. Sepse neve me anë të Frymësë pres-
 më për shpresën' e të-drejtuërit prej besësë.
 6 Sepse mbë Jisu Krishtinë as rrethpresja ka
 ndonjë fuqi, as parrethpresja, po besa që
 vepëronetë me anë dashurie.
 7 Ju ecënitë mirë; kush u pengoj që të
 8 mos bindeni mbë të-vërtetënë? Këta të-bin-
 durë nuk' është prej ati që u thërret juve.
 9 Pakëzë brumë mbruh gjithë të-mbrujturitë.
 10 Unë kam shpresë mbë ju me anë të Zotit,
 se nukë dotë kini ndër mëntt tjetërë gië; po
 ay që u trumbulon juve, cilido që të jetë, ay
 11 ka për të mbajturë mundimnë. Edhe unë, o
 vëllezër, ndë qoftë se lëçis edhe më rreth-
 presje, përse ndiqem më? atëhere uprish
 12 skandhalia e kryqit. Zoti dhëntë të copëto-
 nenë ata që u trumbullonjënë juve.
 13 Sepse ju, o vëllezër, uthërritë ndë liri; ve-
 tëmë mos e përdorni lirinë për shkak të mi-
 shit, po me anë të dashurisë t'i shërbeni
 14 njëri tjetërit. Sepse gjithë nomi mhushtë
 ndë një fjalë, ndë këtë, „Të duash të-afër-
 15 minë t'ënt si vetëhenë t'ënde.“ Po ndë kaf-
 shofshi e ndë hëngërshi njëri tjetërinë, shi-
 koni mos prisheni njëri prej tjetërit.
 16 Them pra, Ecëni pas Frymësë, edhe nukë

- 17 dotë bëni dëshërimn' e mishit. Sepse mishit dëshëron kundrë Frymësë, e Fryma kundrë mishit; edhe këto janë njëra kundrë tjetrësë,
- 18 që të mos bëni ato që doni. Po ndë qoftë se Fryma u heq udhënë juve, nukë jeni ndënë nom.
- 19 Edhe punërat' e mishit janë të-çfaqura; të-cilatë janë pëgërësi, kurvëri, ndyrësi, plank-prisësi, Idhullatri, magji, armiçësira, grindje,
- 20 zili, zëmërimë, të-zëna, të-ndara, erezsi, Cmire, vrasje, të-dejtura, lodrëti, edhe kësosh si këto; për të-cilatë u them juve më përpara, sikundrë edhe u thashë më përpara, se ata që punonjënenë të-tillatë mbretëri Perëndie s' kanë për të trashëguarë.
- 22 Po pem' e Frymësë është dashuri, gëzim, paqtim, zëmër' e-gjerë, ëmblësirë, mirësi, besë,
- 23 Butësirë, vetëpërmbajtje; kundrë të-tillavet nukë ka nom.
- 24 Edhe ata që janë të Krishtit, e kanë kryqësuarë mishinë bashkë më pësimet' e me dëshërimetë. Ndë rrojmë pas Frymësë, pas Frymësë edhe të ecëjmë.
- 26 Letë mos kërkujmë lavdi të-kotë, dyke ngarë njëri tjetërinë, dyke pasurë cmir njëri tjetërinë.

Krye 6.

- 1 O vëllezër, edhe ndë rëntë njeri ndë ndonjë faj, ju që jeni të frymësë ndërto-e-ni të-

- tillinë me frymë butësi; dyke vënë re vetëhenë t' ende, semos ngitesh edhe ti. Mbani barrëtë njëri tjetërit, edhe kështu mbushni nomn' e Krishtit. Sepse ndë i duketë ndonjëj se diç është, tek s' është gjë, gënjen vetëhen' e ti. Po gjithë-sicili letë provonjë punën' e ti, edhe atëhere vetëmë për vetëhen' e ti dotë ketë të-mburruritë, e jo për tjetërinë; Sepse gjithë-sicili dotë mbanjë barrën' e ti.
- 6 Edhe ay që mësonetë ndë fjalët prej ndonjëj, atë që e mëson let'a bënëj pjesëtar ndë gjithë të-mirat të tia. Mos gënjeji; Perëndia nukë përbuzetë; sepse ç' të mbjellë njeriu, këtë edhe dotë korrnjë; Sepse ay që mbjell ndë misht të ti, prej mishit dotë korrnjë prishje; po ay që mbjell ndë Frymët, prej Frymësë dotë korrnjë jetë të-përjetëshme. Letë mos lodhemi pra dyke bërë të-mirënë, sepse ndë mos ulothçimë, dotë korrme ndë kohët që duhetë. Përandaj gjersa kemi kohë, letë punojmë të-mirënë mbë të-gjithë, po më fort mb' ata që janë ndë një besë me ne.
- 11 Shikoni me ç'farë shkronja të-mëdha u shkrova me dorënë t' ime. Sa duanë të dukënë të-mirë ndë misht, këta u ngutnjënë juve të rrethpriteni, vetëmë që të mos ndiqenë për kryqin' e Krishtit. Sepse as ata që rrethpritenë s' e ruajnënë nominë, po duanë të rrethpriteni ju, që të mburrenë ndë misht t' uaj.
- 14 Po për mua qoftë lark të mburrem për tja-

- tërë gjë*, veç për kryqin'e Zotit t'ënë Jisu Krisht, me anë të të-cilit bota është kryqëzu-
- 15 arë tek unë, edhe unë te bota. Sepse mbë Jisu Krishtinë as rrethpresja ka fuqi, as pa-
- 16 rrethpresja, po kriesa e-re. Edhe sa ecënjënë pas kësaj rregulle, *qoftë* paqtim edhe përdëllim mb'ata, edhe mbë Israilin'e Perëndisë.
- 17 *Ndashiti e* paskëtaj asndonë letë mos më mundonjë: sepse unë mbanj shënjat' e Zotit Jisu ndë trupt t'im.
- 18 Hiri i Zotit t'ënë Jisu Krisht qoftë bashkë me frymënë t'uaj, o vëllezër. Amin.
-